

**UNITED  
NATIONS**  
United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPTI  
I MBLEDHJES KOMEMORATIVE ME RASTIN E VDEKJES SË  
PRESIDENTIT TË KOSOVËS, DR. IBRAHIM RUGOVA**

**TRANSKRIPT  
SA KOMEMORATIVNE SEDNICE POVODOM SMRTI  
PRESEDNIKA KOSOVA, DR. IBRAHIMA RUGOVE**

---

*Janar – Januar 2006*

TRANSKRIPTI  
I MBLEDHJES KOMEMORATIVE ME RASTIN E VDEKJES SË  
PRESIDENTIT TË KOSOVËS, DR. IBRAHIM RUGOVA

**Mbledhja komemorative u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës më 22.01.2006, në orën 12,00.**

**Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës**

**KRYETARI:** Më lejoni që në këto momente, ndër më të vështirat për institucionet e Kosovës dhe për popullin e saj, por edhe për Bashkësinë Ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, t'ju ftoj që me një minutë heshtje t'i shprehim nderimet tona për jetën, për veprën dhe për punën e presidentit Rugova.

Ju ftoj për një minutë heshtje.

**L a v d i**

E nderuara familje e presidentit Rugova, pranoni ngushëllimet e mia në këtë pikëllim të madh, që po e përjetoni dhe të jeni krenarë, sikur që jemi edhe të gjithë ne me jetën dhe me veprën e presidentit Dr. Ibrahim Rugova, që si askush tjetër e ngriti popullin e Kosovës, ia rriti dinjitetin dhe i ndërtoi themelet e ardhmërisë evropiane të Kosovës. I nderuari kryeministër, të nderuar ministra, i nderuari kryeadministrator i Kosovës z. Soren Jesen Petersen, i nderuari gjeneral Valoto, i nderuari ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Goldberg, ju falënderojmë edhe për gjithë ndihmën e pakursyer të mjekëve tuaj që deri në çastet e fundit ishin pranë presidentit tonë të dashur.

Të nderuar shefa të zyrave përfaqësuese të institucioneve ndërkombëtare që po jepni kontribut të vazhdueshëm në ndihmë Kosovës, të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare, i nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, i nderuar kryetar i Këshillit të Universitetit, prof. Jahi Hoxha, të nderuar deputetë, jemi mbledhur këtu për t'i bërë nderime presidentit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, që me gjithë jetën dhe me veprën e vet ishte në shërbim të popullit të Kosovës, vepra dhe angazhimi i tij ishin shtylla kryesore dhe bazament i palëkundshëm i Kosovës së lirë, shtet i pavarur dhe sovran.

Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, nga tradita atdhetare i pasur, por e zgjodhi jetën e intelektualit, duke i arritur majat e dijes dhe të vështrimit kritik, nga e kaluara i nxori të gjitha ato vlera aq të dobishme për ne sot dhe për brezat e ardhshëm, duke ndjekur fillin e mendjes së ndritur të atyre ideve që materializohen dhe bëhen të pandalshme për arritjen e qëllimeve dhe të synimeve të drejta e humane, të përmbliidhen në liri, demokraci, barazi e pavarësi. Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, bëri shkëputje të hershme nga intelektualit për vete, nga rehatia dhe shoqërimi me librat dhe me ambientet e mbyllura intelektuale, për t'u bërë një tribun i vërtetë i popullit, një njeri që digjet dhe fiket për interesat madhore, për atë që populli

i tij, si dhe popujt e tjerë, të jetojë në paqe, në harmoni, në liri dhe i qetë, duke ndërtuar dhe projektuar me dinjitet ardhmërinë e vet.

Që në vitet e tetëdhjeta të shekullit XX, Dr. Ibrahim Rugova, u vu në krye të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, duke i dhënë asaj një frymë demokratike dhe evropiane në kohën kur të gjithë kishin rënë nën dhunën e nacionalizmit dhe të shovinizmit. Dinamizmi i jetës shoqërore, kulturore dhe politike në Kosovë bëri që pikërisht këtu të formohej lëvizja e parë demokratike në Evropën Juglindore dhe në vendet komuniste në përgjithësi. Ishte kjo Lidhja Demokratike e Kosovës, lëvizja më masive ndonjëherë ndër shqiptarë, por edhe e paparë deri atëherë edhe ndër vendet e tjera. Pikërisht kosovarët ishin të parët në histori që i hodhën librezat e kuqe të komunizmit, duke bërë që ai brenda dy ditësh të binte me turp në gjithë Kosovën për të mos u kthyer asnjëherë në këto hapësira. Filozofia e urtë dhe origjinale e presidentit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, krijoi një lëvizje, një organizim që ishte shtet yni demokratik, në një shtet të egër dhe diktatorial e që i krijoi të gjitha strukturat e mëvetësishme që funksiononin në të gjitha fushat e jetës, në arsim, në shëndetësi, në ekonomi dhe në financa, madje deri në organizimin e zgjedhjeve parlamentare dhe në ndërtimin e institucioneve shtetërore. E gjithë kjo me një organizim të admirueshëm nxiti edhe ndihmën ndërkombëtare për çështjen tonë kombëtare.

Lufta çlirimtare e popullit tonë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ishte kundërvënie e drejtë dhe e pranueshme kundër regjimit pushtues serb zbatonte shtypjen, gjenocidin dhe politikën shfarosëse kundër popullit të Kosovës. Kjo nxiti intervenimin ushtarak të NATO-s dhe ndihmën e pakursyeshme të gjithë bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me të cilat, siç thoshte presidenti ynë i nderuar, populli ynë lidhi miqësi të përhershme.

Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, ishte fitues i të gjitha zgjedhjeve të deritashme demokratike në Kosovë. Pikërisht ai këtu e shihte parimin demokratik që të bëhen koalicione dhe të qeverisjet së bashku me subjektet e tjera. Kjo ishte dhe mbeti karakteristika unifikuese dhe dëshmia e një shpirti të hapur demokratik me vizion të qartë për ardhmërinë. Filozofia paqësore e presidentit Dr. Ibrahim Rugova ishte filozofi politike e ngritjes dhe e përgatitjes së popullit, ishte filozofi evropiane e argumenteve, e veprimit dhe e organizimit që sot i krijoi ato standarde dhe parametra që Kosovën e bëjnë vend demokratik evropian, vend ku të gjithë qytetarët e saj jetojnë të lirë dhe të barabartë. Ndërtimi i institucioneve shtetërore të Kosovës pati përherë mbështetjen e presidentit Rugova, që nuk kurseu asgjë, por që flijoi çdo gjë që ne sot të ndihemi dhe të jemi mirë. Kosova është krenare që e pati Dr. Ibrahim Rugovën, por Kosova është e sigurt për të ardhmen e saj, sepse e ka veprën e presidentit Dr. Ibrahim Rugova. Le të pushojë i qetë në parajsë presidenti ynë! Zoti e bekoftë familjen Rugova që Kosovës ia fali birin e saj. Zoti i bekoftë miqtë tanë ndërkombëtarë. Zoti i bekoftë Kosovën dhe popullin e saj!  
Ju faleminderit!

E ftoj z. Soren Jesen Petersen që me një fjalë rasti t'u drejtohet këtij tubimi për kujtimor dhe Parlamentit të Kosovës. Foltorja me kënaqësi është juaja z. Petersen.

**SOREN JESEN PETERSEN:** Familje e nderuar e kryetarit Rugova, i nderuar kryetar i Kuvendit, i nderuar kryeministër, anëtarë të Qeverisë, komandant i KFOR-it , ambasadori Kolbert, mysafirë të nderuar dhe miq.

Sot ju drejtohem me një pikëllim të thellë, pikëllim që e di se e ndani edhe ju në këtë Kuvend, si tërësi. Ne, natyrisht ,që të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm për seriozitetin e sëmundjes së kryetarit, por megjithatë lajmi i djeshëm ishte një shok për të gjithë ne. Ibrahim Rugova ka qenë një element përkufizues i politikës në Kosovë për një kohë shumë të gjatë, prandaj është vështirë për ne që Kosovën dhe politikën saj ta paramendojmë pa të.Takimi im i parë me kryetarin ishte ne vitin 1996.Që atëherë ai më ka lënë përshtypje me vizionin politik të vazhdueshëm dhe me përkushtimin e tij për arritjen e një qëllimi të vetëm, qëllim të cilit ai ia përkushtoi tërë jetën, qëllim që ishte Kosova e lirë. Ky është një vizion dhe është qëllim i popullit shumicë në Kosovë dhe shumica ose i tërë ky Kuvend është vizion, realizimi i të cilit mbetet në duart tuaja, në duart e udhëheqësve politik të Kosovës,bashkimi dhe përkushtimi i të cilëve është vital për muajt e ardhshëm. Ne e kemi humbur kryetarin Rugova në një moment shumë të ndjeshëm. Kjo është vërtet tragjedi njerëzore, por sot nuk është momenti të diskutojmë në detaje për çështje të tilla. Sot është ditë kur duhet të ndajmë dhimbjen me familjen e kryetarit Rugova, që mund ta ndajmë, por nuk mund ta zvogëlojmë.

Sot është ditë kur ne duhet të vëmë në spikamë të arriturat e një njeriu që përpjekjet dhe shpresat e Kosovës ia ka bërë të ditura mbarë botës dhe këtë ai e ka arritur përmes një vizioni, falë mençurisë dhe ngrohtësisë së tij.

Kosova ka humbur një udhëheqës shumë të madh. Ai do të përkujtohet gjatë rrugëtimit të Kosovës për ta përmbushur vizionin e tij dhe le të qëndrojë shpirti i tij në të gjithë ne, le të prehet i qetë.

### ***Fjala e z. Petersen është e marrë nga përkthimi***

**KRYETARI:** Z. Petersen ju faleminderit për porosi të ngrohtë. Një fjalë në përkujtim të veprës dhe të personalitetit të presidentit e ka kryeministri i Kosovës, Bajram Kosumi. Foltorja është për ju, z. Bajram Kosumi.

**KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:** E nderuara familja Rugova, i nderuari kryetar Daci, i nderuari përfaqësues special z. Golberg, z. Petersen ,z. Valoto, deputetë të nderuar, zonja dhe zotërinj.

Më lejoni që fillimisht t'ju shpreh juve dhe familjes së presidentit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, ngushëllimet më të sinqerta për vdekjen e njeriut të paqes dhe të pavarësisë së Kosovës.

Presidenti Rugova, që i filloi proceset në Kosovën e pas komunizmit ,që ka sfiduar politikat e shtypjes gjatë viteve të nëntëdhjeta, ka krijuar një imazh të ri të Kosovës në botë, i ka dhënë forcë dhe e ka orientuar lëvizjen e rezistencës popullore për liri dhe pavarësi. Nën udhëheqjen e tij lëvizja patriotike në Kosovë shpërtheu kufijtë kombëtarë dhe krijoi imazhin e një lëvizjeje moderne dhe perëndimore. Lëvizja

patriotike e shekullit XX në Kosovë, e udhëhequr nga ai dhe e ngritur në filozofi moderne dhe politike dhe me praktikë të një rezistence paqësore, kulmoi në vitet e nëntëdhjeta me luftën për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me intervenimin e NATO-s. Kjo është historia e Kosovës gjatë një shekulli të plotë. Kjo lëvizje ia vuri themelet shtetit të ri të Kosovës që tashmë është në fazë të fundit të krijimit. Presidenti Rugova ishte bartës i proceseve në Kosovë, ndërtues i institucioneve dhe njeri i durimit. Është cilësuar si njeri i pavarësisë dhe me të drejtë emri i tij është i lidhur pashkëputshëm me pavarësinë e Kosovës. Vizioni i tij për një Kosovë të pavarur dhe sovranë është themeli mbi të cilin po ndërtohet Kosova e ardhmërisë dhe e përparimit dhe Kosova e Evropës së bashkuar me një miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Presidenti Rugova edhe përtej kufijve të Kosovës, kudo nëpër botë, ka krijuar imazhin e njeriut të pavarësisë së Kosovës. Ne i kemi borxh njeriut të paqes dhe të pavarësisë për ta bërë shtetin e Kosovës, amanetin e tij më të shenjtë dhe më të madh, i kemi mbetur borxh njeriut të Kosovës që ta ndërtojmë Kosovën shtet të qytetarëve të saj. Ai ishte njeri i bashkimit dhe i tolerancës, njeri i mirëkuptimit dhe i forcës intelektuale, njeri i së tashmes dhe i së nesërme. Historia do ta çmojë dhe do t'ia bëjë vendin më meritues presidentit të parë të Kosovës së lirë. Në këto çaste të pikëllimit dhe në periudhën më të rëndësishme të historisë së Kosovës, kur me të drejtë pritnim që presidenti të na udhëhiqte drejt përmbushjes së vullnetit të popullit të Kosovës, neve na duhet më shumë se kurrë bashkimi ynë, duhet t'i ruajmë bashkimin dhe pjekurinë tonë politike për ta rrumbullaksuar procesin, në të cilin kemi hyrë. Qytetarët e Kosovës këto çaste të rënda që po i përjetojnë, me besim të plotë, do t'i tejkalojnë me dinjitet dhe pjekuri të madhe. Të gjitha institucionet e Kosovës dhe partitë politike jemi të vendosur dhe të bashkuar që t'i përmbushim obligimet tona kushtetuese për ta ndërtuar shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Ne do të mbajmë zi për presidentin dhe do ta kujtojmë me respekt punën e tij të madhe, madje asnjë moment nuk do të ndalemi së punuari, vetëm që ta bëjmë praktikë praktike shtetin e Kosovës dhe në këtë mënyrë edhe atij do t'i bëjmë nderimin më të madh, ne mund ta bëjmë këtë së bashku dhe me ndihmën e miqve tanë.

Le të prehet në paqe shpirti i presidentit Rugova. Lavdi i qoftë.

**KRYETARI:** Kryeministër ju faleminderit.

Me kaq ky tubim përkujtimor merr fund.

Ju faleminderit.